



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 15/11

Prishtinë, më 15.06.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Duda Balje, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza-Ministër i Financave, Ymer Havolli, Adrian Zalli dhe Vërshim Hatipi nga TKPK-ja, Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit, Teki Shala, Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI, OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, datë 02.06.2011;
3. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Financave për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me normat e propozuar nga Ministria për vënien e tatimit të akcizës në vetura. I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010. I ftuar: Ymer Havolli, Kryesues i Bordit Udhëheqës të TKPK-së.
5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010. E ftuar: Valdete Daka, Kryetare e KQZ – së;
6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit sipas Qarkores buxhetore 2012/01. I ftuar: Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit
7. Shqyrtimi i Projektligji nr. 04/L-004 për Shërbimet e Sigurisë Private me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-014 për efikasitetin e energjisë, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës, njoftoi se për pikën e pestë, përfaqësuesit e KQZ-së, për shkak se gjindet në udhëtim zyrtar Konferencën vjetore e 20'të e ACEEEO-se në Budapest, kanë kërkuar që të shtyhet në një mbledhje.

Hykmete Bajrami, kërkoj që raporti i KQZ-së të shqyrtohet, pasi që të vjen edhe raporti i auditorit.

Kryetarja, sqaroi se raporti i auditorit mund të shtyhet dhe nuk mund të dihet se kur vjen ky raport. Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të kërkojë vetëm detalizime lidhur me pjesën financiare të raportit vjetor dhe ka për detyrë që ta kalojë apo mos ta kalojë raportin vjetor financiar.

Rendi ditës miratohet me ndryshime. Pika e pestë shtyhet në një mbledhje tjetër të komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, më datë 02.06.2011

Hykmete Bajrami, kërkoj që në diskutimin e saj për KASH-in, në vend të “5.500 vende të reja të punës” të përmirësohet me “55.000 vende të reja të punës”.

Procesverbali miratohet me këtë ndryshim.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Financave për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me normat e propozuara për vënien e tatimit të akcizës në vetura

Kryetarja, theksoi që me nenin 3.1 të Ligjit për Taksën e Akcizës në Kosovë, Ministria e Financave në emër të Qeverisë ka kërkuar nga Komisioni të konsultohet lidhur me propozimin për normat e akcizës të veturave të importuara, vendimin e të cilit e merr Qeveria.

Bedri Hamza, kur në treg është rritur kërkesa për vetura si dhe funksionon qendra e homologimit, për të konstatuar se veturat i plotësojnë kushtet e sigurisë në trafik, Ministria e Financave ka marrë iniciativën për të rritur limitin kohor për lejimin e importit të veturave më të vjetra se tetë vite si dhe për të propozuar normë të re të tatimit të akcizës, duke marrë parasysh vitet e vjetërsisë dhe fuqinë e motorit të veturave. Gjatë analizës kemi pasur parasysh aspektin social, aspektin e buxhetit, aspektin e sigurisë dhe aspektin ambiental.

Naser Osmani, theksoi që gjatë vlerësimeve për ambientin dhe duke marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe sociale të vështirë, a ka Kosova më tepër nevojë për këto 20 milion € apo për ruajtjen e ambientit. Si shoqëri nuk kemi qenë në gjendje të kujdesemi për ambientin dhe këtë e dëshmon

ndërhyrja në natyrë e gurthyeseve të ndryshëm që janë rreth 600 si dhe deponitë e veturave që gjenden rreth rrugëve magjistrale. Po ashtu, është shumë vështirë që të kuptohet se a do të përmirësohet me të vërtetë gjendja sociale nga importimi i veturave më të vjetra se tetë vite, të cilëve do t'u mundësohet që të kenë një veturë shumë të vjetër. Nuk garantohej asnjë siguri për shkak të infrastrukturës së papërfunduar rrugore, dhe duke rritur numrin e veturave të vjetra njëkohësisht do të rritet edhe numri i njerëzve të aksidentuar.

Hykmete Bajrami, po ashtu theksoi që një vendim i tillë do të ketë efekte pozitive vetëm sa i përket mbushjes së arkës buxhetore, ndërsa do të ketë efekte negative edhe në aspektin social edhe në atë ambiental. Ky vendim nuk garanton se veturat që vijnë nga jashtë do t'i zëvendësojnë veturat e vjetra që janë në qarkullim. Kjo do të ishte e justifikueshme, nëse Qeveria do të vinte me një program ashtu që 50% nga fondet e inkasuara nga akciza të përdoreshin për mbrojtjen e ambientit. Vendimi i Qeverisë është munduar të justifikohet me atë se veturat e reja janë liruar nga akciza, mirëpo nga statistikatat shihet që prej 13.232 veturave sa janë importuar në vitin 2010, vetëm 7% prej tyre kanë qenë vetura të reja. Një vendim i tillë theksoi se nuk e përkrahë.

Sali Asllanaj, një kërkesë e këtillë ka karakter ekskluziv të mbushjes së buxhetit, dhe ne nuk jemi të interesuar që të kemi zbrazëtira buxhetore, por se një vendim i këtillë i mundshëm, duhet të ketë karakter social, që mos të kemi diferenca aq të mëdha të akcizës, sepse kjo do të pamundësonte që qytetarët të kenë mundësi të blejnë vetura. Mendimi i tij ishte që akciza të mbetet 500€, për të gjitha kategoritë e veturave.

Latif Gashi, duke ditur faktin e numrit të bashkatdhetarëve dhe interesit të tyre, për të sjell vetura të reja, që do të ndikonin në heqjen nga qarkullimi të veturave shumë të vjetra, që do të ndikojë në ruajtjen e ambientit dhe një hap i këtillë i plotëson nevojat e qytetarëve.

Xhevdet Neziraj, theksoi se është e kuptueshme, që vendimi ka për qëllim mbushjen e buxhetit, dhe kjo duhet të qartësohet. Mirëpo se sa do të ndikojë ky ndryshim i normave të akcizës dhe zgjatja e vjetërsisë në ruajtjen e ambientit, do analizë dhe diskutim. Është marrë një vendim që të largohen disa deponi me vetura të demoluara nga afër rrugës dhe nuk ka ndodhur. Do të ishte mirë që të hyrat nga akcizat, të dedikohen në mbrojtjen e ambientit.

Hasime Krasniqi, vlerësoi se duke ditur funksionimin e procedurës së homologimit të veturave, një vendim i këtillë do të ndikonte në heqjen nga përdorimi i veturave shumë të vjetra. Sa i përket arsyeve për mbushjen e buxhetit, të gjithë e dijmë se shteti buxhetin e mbush nga të hyrat që i inkason në sektorët e veçantë. Gjithashtu kjo do të ndikonte në plotësimin e nevojave të qytetarëve për të blerë vetura sipas standardit që kanë. Megjithatë atë ndoshta mund të diskutohen ulja e normave e propozuara të akcizës për veturat deri 13 vjet, pasi që për automjetet e reja nuk është ndonjë shumë e madhe.

Kryetarja, theksoi se nuk është vetëm arsyeja e mbushjes së buxhetit, po ka pasur kërkesa nga qytetarët që të zgjatet afati. Duhet të jemi të interesuar për ruajtjen e ambientit, por se ndotja e ambientit ndodhë më shumë prej gjerave tjera se sa prej makinave. Përkrah mendimin se nga përdorimi munde të hiqet një numër i madhë i makinave, shumë të vjetra dhe të zëvendësohen me më të reja. Ndoshta do të ishte mirë të shikohet mundësia e reduktimit të normave të propozuara të akcizës. Sa i përket vjetërsisë, nuk do të duhej të vendosim standarde që nuk i kanë vendet e rajoni apo të Evropës

Bedri Hamza, sa i përket nevojës buxhetore, të hyra që parashihen të realizohen më këtë vendim, mund të realizohen edhe në forma tjera. Sa i përket aspektit ambiental dhe atij të sigurisë sqaroi se përpjekjet maksimale do të jenë që qendrat e homologimit të kryejnë punën e tyre, sepse vendimi është marrë në kohën kur nuk kanë ekzistuar këto qendra. Sa i përket akcizës së përshkallëzuar, qëllimi ka qenë që të stimulohet blerja e veturave më të reja. Një vendim që është në kundërshtim me praktikën e vendeve të Evropës.

Naser Osmani, sa i përket përshkallëzimit të akcizave, sa më të vjetra që të jenë veturat aq më të larta duhet të jenë edhe akcizat, sepse kështu mund të stimulohet blerja e veturave më të reja si dhe kështu mund të ketë edhe siguri e edhe ambient më të pastër.

Pas diskutimeve, komisioni me pesë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Jelena Bontić dhe Duda Balje), katër vota Kundër (Naser Osmani, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi), dhe dy abstenime (Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), nxorri këtë:

PËRFUNDIM

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu propozimin e Ministrisë së Financave për ndryshimin e normave të tatimit të akcizës në vetura, në Aneksin A të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për 2010

Ymer Havolli, njoftoi se në viti 2010 ka shënuar një rritje prej 5,18% të kthimit të investimeve në krahasim me vitin 2009. Bordi ka bërë plasmane të matura në tregjet botërore, në aset menaxherët që i kemi pasur me herët dhe në aset menaxherët e ri. Po ashtu kemi pasur kthime në vlerë prej 18.000.000 € nga këto plasmane. Edhe Auditori i Përgjithshëm e ka konfirmuar saktësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare si dhe TKPK-ja ka pasur edhe një inspekcioni nga BQK-ja. Staf i TKPK-së është në kontakt me ATK-në që mjetet e pa alokuara të bien në nivel edhe më të ulët. Kontributet pensionale të paguara kanë shënuar rritje rreth 14.4 %. Gjatë vitit 2010 në TKPK janë tërhequr kursime pensionale prej 2.729 llogarive, duke shënuar një rritje prej 37%. Shpenzimet operacionale kanë mbetur pothuajse të njëjta, ndërsa shpenzimet e investimeve janë rritur, të cilat janë në proporcion të drejtë me mjetet që janë në menaxhim.

Kryetarja, nga raporti shihet një përshkrim i punës, por ato çështje që kanë qenë fokus i interesimit nga deputetët, nuk janë të pasqyruara në raport. Kuvendi ka kërkuar që të jetë me e detalizuar çështja e pagesave të cilat bëhen në TKPK, sidomos për postet udhëheqëse. Nga raporti shihet që janë tërhequr mjetet nga Procredit Bank, për të cilin kërkoi sqarime. Gjithashtu, është bërë një krahasim në formë tabelare të taksës menaxhuese dhe të pagave, që duket një krahasim i pa nevojshëm. Një çështje tjetër shqetësuese është mjetet që i investojnë qytetarët në TKPK, edhe pse po shihet një kthim pozitiv, megjithatë ende 17.429.000 €, nuk janë atribuuar në llogaritë individuale, dhe për këtë kërkoi të dhëna më të detalizuara për të parë, se ku janë defektet.

Muhamet Mustafa, parashtroi dy pyetje: sa është kompenzuar vlера pas humbjes drastike të vitit 2008-2009, dhe sa është numri i kontribuesve? Do të duhej shprehur rritja e tyre në përqindje, sepse kjo është një sinjal edhe i punësimit? Një çështje tjetër është roli i Kuvendit në menaxhimin e mjeteve, sepse ligji ekzistues, po e bjen TKPK-në në një pozitë të favorshme në treg.

Latif Gashi, shprehu interesim për kriteret të cilat janë përdorur për caktimin e bazës së të ardhurave personale, sidomos për stafin udhëheqës, duke pasur parasysh që flitet se janë të ardhura shumë të mëdha.

Sali Asllanaj, theksoi që proporcioni i investimeve që bëhen jashtë me këto mjete të trustit është shumë i pafavorshëm. Kërkoj që të inkurajohen që këto mjete të investohen më tepër në Kosovë, qoftë edhe me rrezik. A ka mundësi ligjore që të bëhet kjo? Në opinion flitet që pagat e trustit janë të larta duke ditur që ju operoni në një treg evropian, kështu që të ardhurat janë në proporcion me tregun në të cilin operohet.

Naser Osmani, shprehu një vërejtje lidhur me mënyrën e përpilimit të raportit në përgjithësi, duke theksuar që në raport nuk shënohet biografia e punëtorëve të Bordit dhe nuk shënohen çështjet politike në raport. Në faqen 31 për investime në Greqi, pyeti sa ka qenë e sigurt të bëhet kjo?

Ymer Havolli, sqaroi se të ardhurat e menaxhmentit të trustit janë bërë publike në Agjencionin Kundër Korrupsionit. TKPK-ja ka investuar vetëm në dy banka, në Raiffeisen Bank dhe NLB, ndërsa janë tërhequr mjetet nga Procredit Bank, për shkak se kjo bankë ka dashur që t'i marrë mjetet pa garancion. Sa i përket investimeve brenda Kosovës, me ligj lejohet vetëm 5 % e mjeteve të një aset menaxheri. Lidhur me vërejtjet për fushatë, sqaroi se kjo nuk ka qenë fushatë politike, por ka qenë fushatë për edukimin e kompanive.

Adrian Zalli, lidhur me mospagesat, sqaroi se ATK-ja është e obliguar ligjërisht për dërgimin e listave, e cila i ka agjentët e vet që i marrin listat e punëtorëve për obligimet pensionale të cilat sillen në TKPK. Një numër i bizneseve kanë falimentuar dhe tani më nuk ka mundësi që të merren ato lista dhe si pasojë ka mbetur një pjesë e mjeteve të pa alokuara.

Vërshim Hatipi, për mjetet e pa alokuara arsyetimet janë dhënë në faqen 42, njëra prej të cilave është mungesa e raporteve. Sa i përket statistikave të punësimit, janë bërë përpjekje që të paraqiten kontribuesit aktivë ku vërehet një trend pozitiv, pastaj paraqiten kontributet mesatare dhe llojet e ndërmarrjeve duke përmendur që këto të dhëna nuk i ka ATK-ja.

Pas diskutimeve, komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

I. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor i punës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2010.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010

Shtyhet për mbledhjen tjetër të komisionit.

6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit sipas Qarkores buxhetore 2012/01

Kryetarja, në kërkesat e Kuvendit, bazuar në qarkoren e parë buxhetore, shifen lëvizje në buxhet në krahasime më atë të vitit 2011, duke përfshirë uljen e pagave të deputetëve për arsye se nuk i kemi deputetët, të cilët gjatë këtij viti janë paguar. Në këtë qarkore përfshihet edhe një rritje e pagave të administratës, si rezultat e shtimit të numrit prej 15 të punësuarave, po ashtu ka shtim të mjeteve kapitale për 300.000 €.

Hykmete Bajrami, kërkoi sqarime për programin e administratës së Kuvendit për shpenzimet e udhëtimit brenda vendit në vlerë prej 10.000 €, pasi që janë paraqitur dy kategori të ndara. Po ashtu pyeti edhe për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve që përfshinë shumën prej 25.000 € në vit, si dhe sa është numri i veturave që ka Kuvendi? Përmendi edhe kategorinë e reklamave dhe të konkurseve që është në vlerë prej 10.000€, duke e konsideruar të lartë këtë shifër, duke pasur parasysh kufizimet buxhetore.

Ismet Krasniqi, sqaroi se konkursi në tërësi ka disa shpenzime që e tejkalojnë kodin e administratës për faktin se Kryesia e Kuvendit shpall konkurse edhe për agjencione, prokurimin dhe Kuvendin, të cilat janë të obliguara të shpallen në të gjithë shtypin ditor, ndërsa për administratë shpallen në dy gazeta ditore dhe në radion Blue Sky në gjuhën serbe, por gjithmonë me rotacion. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit brenda vendit për administratën, sqaroi se administrata i ka disa takime punuese jashtë ndërtesës, siç është strategjia legislative, pastaj pritjet me parlamentet e vendeve tjera. Sa i përket sigurimit të veturave njoftoi që janë afër 28 vetura të kategorisë së lartë dhe të gjitha sigurohen me Kasko.

Komisioni me dhjetë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa dhe Xhevdet Neziraj) dhe një abstenim (Albana Fetoshi), nxorri këtë:

REKOMANDIM

- I. Kryesia e Kuvendit të miratojë kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012, dhe t'i rekomandojë Ministrisë së Financave që të njëjtat t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012.
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbimet e Sigurisë Private me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Kryetarja, konstatoi se komisioni njëzëri nxorri këtë rekomandim:

REKOMANDIM

- I. Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

- 9. Shqyrtimi i Projektligjit për Gjendjen Civile me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Kryetarja, konstatoi se komisioni njëzëri nxorri këtë rekomandim:

REKOMANDIM

- I. Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

- 10. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/18 për Tregtinë e Brendshme me raportin me amendamente të komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Hykmete Bajrami, theksoi nuk duhet që gjohet në një shtet të bazohen në mbushjen e buxhetit, përderisa te ne ndodhë që të rriten prej 1.000 në 3.000.

Kryetarja, sqaroi se çështja e gjobave nuk është çështje e implikimeve buxhetore, sepse nuk e pengon zbatueshmërinë e ligjit.

Kryetarja, pas diskutimeve, konstatoi se komisioni njëzëri nxorri këtë rekomandim:

R E K O M A N D I M

I. Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

11. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04-L/014 për efikasitetin e energjisë me raportin me amendamente të komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja, konstatoi se komisioni njëzëri nxorri këtë rekomandim:

R E K O M A N D I M

I. Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

12. Të ndryshme

12.1 Takimi i komisionit me përfaqësuesit e Komisionit Evropian

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit, për takimin që do të zhvillohet në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me përfaqësuesit e Komisionit të Kontrollit të Buxhetit nga Komisioni Evropian, më 15.06.2011 dhe 16.06.2011.

12.2 Miratimi i raportit vjetor financiar i Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2010

Kryetarja, njoftoi që Komisioni për Ndihmë Juridike, ka sjellur raportin plotësues financiar, ku janë sqaruar çështjet e ngritura nga komisioni.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

I. i rekomandohet Kuvendit miratimin e raporti vjetor financiar i Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2010.

12.3 Informata për përmbushjen e obligimeve të Komisionit, që dalin nga Plani i Veprimit të Kuvendit në vështrim të Raportit të Progresit për Kosovës për vitin 2010

Kryetarja, i njoftoi anëtarët se më qëllim të përmbushjes së detyrave të Komisionit, të përcaktuara me Planin e Veprimit të Kuvendit në vështrim të Raportit të Progresit për Kosovës për vitin 2010, ka kërkuar informata nga institucionet relevante, që ti dërgojnë brenda dhjetë dite.

12.4 Miratimi i listës së ekspertëve për angazhime për nevoja të komisionit

Kryetarja, konstatoi se u miratuar lista e ekspertëve, me tre anëtarë plotësues: Veton Zeqiraj, Valentin Toçi dhe Burim Zagragja.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj